



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 74 prot.

Kamëz, më 17.06.2022

V E N D I M  
Nr. 61 .Datë 17/06 2022  
M B I

**“DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.43, DATË 18.11.2019, TË KËSHILLIT BASHKIAK” PËR ORGANIZIMIN E VEND PARKIMEVE TË TRANSPORTIT TAKSI 4+1 NË TË GJITHË TERRITORIN E BASHKISË KAMËZ”**

**Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 17.06.2022, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.58 Datë 08.06.2022 në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligji Nr. 8308, datë 18.03.1998 “ Për Transportet Rrugore” i ndryshuar, Kryetari i Bashkisë pasi shqyrtoi Relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Transportit, Lejeve dhe Liçensave, i propozon Këshillit Bashkiak të miratojë Projekt Vendimin “ Për Disa Shtesa në Vendimin Nr.43,datë 18.11.2019, të Këshillit Bashkiak” Për organizimin dhe përcaktimin e vend parkimeve të Transportit Taksi 4+1 në të gjithë territorin e Bashkisë Kamëz”, **Këshilli Bashkiak Kamëz”;****

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e ndryshimit për disa shtesa në vendimin Nr.43,datë 18.11.2019, të Këshillit Bashkiak “Për organizimin dhe përcaktimin e vend parkimeve të Transportit Taksi 4+1 në të gjithë territorin e Bashkisë Kamëz”, si më poshtë:
  1. Në pikën 1, të shtohen 5 vende parkimi në “Rrugën Skënderbeu”, Kamëz.
  2. Në pikën 2, të shtohen 8 vende parkimi në “Rrugën Berisha”, Kamëz.
  3. Në pikën 3, të shtohen 7 vende parkimi në “Rrugën Demokracia”, Bathore.
  4. Në pikën 4, të shtohen 11 vende parkimi në “Rrugën Donald Trump”, Kamëz.

Si dhe të shtohen këto vende parkimi të tjera në këto rrugë, si më poshtë:

1. Të shtohen 15 vende parkimi në “Rrugën Abdi Bej Toptani”, Valias.
2. Të shtohen 30 vende parkimi në “Rrugën Nënë Tereza”, Kamëz.
3. Të shtohen 4 vende parkimi në “Rrugën Medi Caka”, Zall Mner.
4. Të shtohen 5 vende parkimi në “Rrugën Londër”, Kamëz.
5. Të shtohen 3 vende parkimi në “Rrugën Shën Gjon Pali II”, Bathore.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

6. Të shtohen 3 vende parkimi në “Rrugën Lidhja e Prizrenit”, Paskuqan.
7. Të shtohen 3 vende parkimi në “Rrugën Halim Xhelo”, Paskuqan.
8. Të shtohen 2 vende parkimi në “Rrugën Korabi”, Paskuqan.
9. Te shtohen 3 vende parkimi në “Rrugën Halit Haxhija”, Paskuqan.
  
10. Te shtohen 12 vende parkimi në “Rrugën Gryka e Kaçanikut”, Laknas.

Bashkëlidhur vendimit dhe hartat përkatëse sipas ndryshimeve të propozuara për secilën rrugë me vendodhjen e saktë dhe përcaktimi i numrit të vend parkimeve Taksi 4+1.

2. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

**Kryetar Këshilli**  
**Hysen KOLDASHI**

